

L I G J
Nr.8760, datë 26.3.2001

**PËR PAGESAT ME KËSTE TË TAKSAVE NGA OPERATORËT PRIVATË RADIO DHE
TELEVIZIVË GJATË PERIUDHËS TRANZITORE TË VITIT 2001**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Pavarësisht nga nenet 33 pika 5 dhe 137 pika 2 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, veprimtaria e subjekteve radiotelevizive të licencuara nuk konsiderohet se është në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse, në qoftë se këto subjekte paguajnë taksat dhe tarifën e tjera në përputhje me këtë ligj.

Përfundimisht për vitin 2000 dhe 2001, detyrimet e operatorëve privatë radio dhe televizivë, që rrjedhin nga ligji nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” do të paguhet me këste tremujore brenda datës 31.12.2001.

Për mospagimin në afat të kësteve zbatohen sanksionet e përcaktuara në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2961, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani